

# BULETINI INFORMATIV

NDIHMJA JURIDIKE PËR PERSONAT NË RREZIK TË PASHTETËSISË/PASHTETËSI

VJETOR - 2021



## SHKURTIMISHT:

- 133 individë të pa dokumentuar, përfitues të ndihmës juridike falas janë pajisur me dokumente të gjendjes civile, të cilat do të ju sigurojnë mundësinë e shfrytëzimit të drejtave dhe shërbimeve të tjera.
- 10 raste të inicuar në procedurë gjyqësore. 3 vendime pozitive të pranuar.
- Kërkesat me natyrë komplekse të 25 individëve janë asistuar me sukses në procedurë administrative.
- 146 individë të pa dokumentuar, kryesisht nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian u identifikuan në nevojë për ndihmë juridike.

BËSHTETJE E OFRUAR PËR PESONAT PASHTETËSI

CRP/K vazhdon të promovojë zgjidhje ligjore për të gjithë personat pashtetësi të cilët nuk mund të marrin shtetësinë në përputhje me kornizën ligjore të përcaktuar në Kosovë.

Si rezultat i avokimit dhe bashkëpunimit me autoritetet përkatëse është bërë e mundur vazhdimi i letërnjoftimeve për 4 persona me status pa shtetësi. Ndërkohë, 3 vendime pozitive janë siguruar, dhe 5 aplikime të tjera janë dorëzuar në muajin shtator. Pajisja e nënave me letërnjoftim, i ka mundësuar CRP/K - ë të vazhdojë tutje me regjistrimin e lindjes së 6 fëmijëve të tyre.

Stafi ligjor i CRP/K - ë ofroi informacion mbi perspektivën e integritet për personat me status pa shtetësi si dhe ofroi mbështetje në arritjen e të drejtave të tyre





FOTOGRAFIA: UNHCR

## “Mos lini askënd pas - Rëndësia e krijimit të identitetit ligjor dhe çasja në të drejta”.

UNHCR, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe CRP/K organizuan konferencën për të adresuar çështjet relevante për personat në rrezik të pashtetësisë dhe me status të dhënë pa shtetësi. Ngjarja mbledhi autoritetet përkatëse, komnatat, organizatat ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe personat në nevojë për të diskutuar sfidat në krijimin e identitetit ligjor, praktikatat e mira, zgjidhjet e mundshme dhe rekomandimet për të reduktuar më tej numrin e personave të peregjistruar. Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) së bashku me institucionet e tjera, njohën nevojën për të vazhduar punën e mëtejshme për çështjet që kanë të bëjnë me parandalimin dhe reduktimin e numrit të personave të peregjistruar dhe/ose me shtetësi të pacaktuar, dhe kështu u zotuan hapur të krijojnë mekanizma për identifikimin, reduktimin, parandalimin dhe mbrojtjen.



## SESSIONET INFORMUESE

Pa një dokument për identifikim ligjor siç është certifikata e lindjes, fëmijët janë ligjërisht të padukshëm. Ata janë në një rrezik më të lartë për t'u përjashtuar nga të drejtat themelore si e drejta në arsim, kujdes shëndetësor dhe shërbime sociale.

Në komunën e Obiliqit janë organizuar **dy (2)** sesione informuese me fëmijët për rëndësinë e regjistrimit të lindjes, si dhe për të drejtat që rrjedhin nga posedimi i dokumentacionit.

Gjatë diskutimeve, fëmijët paraqiten mendimet e tyre se cilat të drejta janë më të rëndësishme. E drejta për identitet ligjor, arsim, kujdes shëndetësor, si dhe trajtim të barabartë ishin disa nga të drejtat më të përmendura.

Së bashku, arritëm në përfundim se regjistrimi i faktit të lindjes ishte pikënisja për realizimin e ëndrrave të tyre, të qenurit mësues, mjek apo sportist.



CRP/K, si pjesë e organizatave të shoqërisë civile dhe partner ligjor i UNHCR-ës, në bashkëpunim me autoritetet vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e kornizës legislative përmes dhënies së opinionit të ekspertit për zbrazëtirat e vërejtura në kornizën aktuale ligjore, dhe zgjidhjeve të mundshme ligjore që do të mundësonin identifikimin dhe reduktimin e numrit të personave në rrezik të pashtetësisë.

Shtatë (7) akte ligjore janë shqyrtuar si dhe komentet/sugjerimet janë pranuar në përmirësimin/forcimin e dispozitave ligjore në përputhje me parimet e legjislacionit ndërkombëtar në fushën e regjistrimit civil dhe shtetësisë.



## Fokus grupet

3 takime të fokus grupeve janë mbajtur me OJQ-të, të cilat punojnë në çështje që kanë të bëjnë me komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptias, përfaqësues nga Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas. Qëllimi ishte optimizimi dhe harmonizimi i qasjes strategjike dhe të përbashkët ndaj shqetësimeve dhe çështjeve të ndryshme që anëtarët e komuniteteve po përballen duke filluar nga regjistrimi i statusit civil, qasja në arsim dhe qasja në shërbime shëndetësore dhe të kujdesit shëndetësor.



**ÇDO JETË KA RËNDËSI.VAKSINOHUNI!!**



**PËR MË SHUMË INFORMACION:  
+383 (0) 38 243 -610 | RR. LORENC ANTONI, NR. 15, 10000 - PRISHTINË**